

Specifikime teknike

Projekt Restaurimi
Objekti : Muzeu Kombetar I Fotografise “Marubi”

Punimet e prishjes do të fillojnë vetëm atëherë kur të jenë siguruar që është stakuar energjia elektrike ose e rrjeteve të tjera alternative pa kompromentuar punimet në kantier. Proçesi i prishjes nuk duhet të vërë në rrezik qëndrueshmërinë statike të objektit; duhet vepruar me kujdes pa shkaktuar dëmtime tek elementët e tjerë konstruktiv mbajtës. Ky zë pune përfshin edhe transportin e materialeve jashtë kantierit.

1.Prishje mur tulle me pastrim

Prishja kryesore e murit te tulates do te jetë për hapjen e një hapësirë rreth 3 meter gjerësi dhe 3.8 meter lartësi në murin ndares. Kjo prishje do realizohet me kujdes duke bërë sigurimin e ambjentit përreth. Per çdo diskutim duhet te konsultohet me supervizorin, si dhe ti referohen nderhyrjeve sipas projektit ne vizatimin teknik. Pas prishjes do te realizohen edhe pastrami dhe heqja e te gjithe inerteve ne ambjent.

2.Çmontim dyer dritare

Ky çmim jepet në lek/m2 dhe përfshin heqjen në këtë rast nga murtaura të cdo lloj dritareje apo dere të specifikuar në projekt. Heqja e dyerve dhe e dritareve do të bëhet me kujdes në mënyrë që të mos dëmtohet muratura

3.Mur me tulla të lehtësuara - 3m, llaç gelqere 1:3

Në ato zona ku më parë është bërë heqja e deres; pastrimi dhe depozitimi i materialeve të nxjerra, aty do ndërhyhet për ndertimin e murit. Materialet e përdorura do jenë llaç gëlqere me raportin 1:3 dhe si mbushës ose elemente që do lidhen me llaç do jenë tullat e hequra nga muri e të depozituara në afërsi. Të kihet kujdes në ruajtjen e orientimit të tullës të vendosur në mure, të vendosen në mënyrë të atille që faqja e vjetër të rakordojë me ringritjen e murit të ri. Gjatë ndërtimit të ruhet orientimi dhe harmonia e vendosjes së tullave. Gjithashtu të kihet parasysh që fugat e krijuara të jenë të njëjtë standart me muraturën e vjetër afër zonës

4.Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25

Ne zonat ne te cilat eshte nderhyre me prishje tani eshte e nevojshme qe te behet mbulimi i muratures. Mbulimi i muratures do behet me llac te njejte ne parametra me llacin e meparshem pra ekzistues. Pasi eshte pergatitur llaci dhe eshte pastruar mekanikisht dhe eshte lare zona qe do suvatohet ateherë merren masat per mbushjen e suvatimit. Ne rast te nevojës per perdorim skelerie do te kemi vendosjen e tyre duke u bazuar ket KTZ te shqiperise. Siguria do te jete primare gjate punes ne suvatim. Ne kete ze do te kihet parasyshe qe te ruhet vazhdueshmeria ne ngjyre dhe siperfaqe te murit ekzistues. Per cdo ndryshim te nevojshem qe nuk eshte parashikuar nga specifikimet teknike subjekti kontraktues do te komunikojë me supervizorin perkates.

5.Tavan I varur me pllka gipsi 60x60cm

Furnizimi dhe vendosja e tavanit te varur do te behet ne tre dhoma kryesore te objektit. Si fillim do te behet çmontimi i elementeve te tavanit aktual te gipsit. Ne vizatim eshte percaktuar si do te realizohet ndertimi dhe hapat qe do te ndiqen. Pllakat e gipsit do te jene te valezuara dhe te vendosura ne drejtim horizontal dhe vertikal, ne mes tyre te vendosura ne forme rombi me dimensione 15 me 15 pllaka gipsi.

6.Sherbetisje e bojatisje me gëlqere

Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e bojës së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje Përpara fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidroplastike të lëngët e cila është e paketuar në kuti 5 – 15 litërshë. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar.

7.Shtrese me pllaka porcelanat

Pas heqjes se murit te tulles, ndares ted y ambjenteve te godines, do te realizohet sistemimi I dysHEMEVE. Ky fragment do te plotesohet me pllaka porcelanat, si ato ekzsituese diku ruajtur menyren e vendosjes.

8.Sistemi elektrik

Në kuadër të këtij projekti, do të realizohet vendosja e prizave, celsave dhe ndricuesve tavanor në ambientin e formuluar, sipas kërkesave të projektit elektrik. Prizat dhe celsat do të instalohen në pozita të përcaktuara në bazë të funksionit të hapësirave dhe përputhshmërisë me standardet e sigurisë. Ndricuesit tavanor do të vendosen në mënyrë të tillë që të sigurohet shpërndarja e barabartë e dritës në ambientet e brendshme. Lidhja e këtyre elementeve elektrike do të bëhet me rrjetin elektrik të godinës përmes kablllove dhe kutive të lidhjes, duke u siguruar që çdo komponent të jetë në përputhje me standardet e sigurisë dhe kualitetit. Projektimi i sistemit elektrik do të bëhet me kujdes për të siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe të sigurt gjatë gjithë kohëzgjatjes së përdorimit të godinës.

9.Sistemi I kondicionimit

Në kuadër të këtij projekti, do të realizohet instalimi i sistemit të kondicionimit dhe ventilimit për të siguruar një klimë të përshtatshme dhe ajër të pastër në ambientet e godinës. Pajisjet e kondicionimit do të vendosen në pozita strategjike për të optimizuar shpërndarjen e ajrit të ftohtë dhe për të siguruar konsumi minimal të energjisë. Sistemët e ventilimit do të sigurojnë shkëmbimin e ajrit të brendshëm me ajër të freskët nga jashtë, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe parandalimin e akumulimit të gazrave të dëmshëm. Lidhja e këtyre sistemeve do të bëhet me rrjetin elektrik dhe tubacionet përkatëse, duke u siguruar që çdo komponent të funksionojë me efikasitet dhe të jetë në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Përdorimi i këtyre sistemeve do të mundësojë një mjedis të shëndetshëm dhe të rehatshëm për përdoruesit e godinës.

Punoi: Sabrina Kuçi
Fatjon Mlloja

Miratoi:
Petrit Bilali, Pergj Sektori AAAMTK

Drejtor
Amila Gjyrezi